

URDHËR
Nr. 335, datë 18.6.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike”,

URDHËROJ:

1. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, të deleguara te zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, me urdhër të ministrit të Drejtësisë nr. 720, datë 6.2.2024, “Për autorizimin dhe delegimin e disa kompetencave/autoritetit të ministrit të Drejtësisë zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta”, për periudhën 18.6.2024–28.6.2024, delegohen te Sekretari i Përgjithshëm, z. Ismail Shehu.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, z. Ismail Shehu, për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja